

DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT



BANKA E SHQIPËRISË

Sigurimi i kushteve normale të punës në veprimtarinë e përditshme të Bankës, nëpërmjet mirëadministrimit e mirëmbajtjes së aktiveve të qëndrueshme dhe pasurive të tjera. Në funksion të kësaj detyre realizohen:

- Hartimi i grafikut të prokurimeve të fondeve të buxhetit, ndjekja dhe përfundimi i të gjitha procedurave administrative të prokurimit deri në marrjen në dorëzim të mallit apo në dorëzimin e objektit të ndërtimit.
- Organizimi dhe administrimi për mirëmbajtjen dhe riparimet e sistemeve, të pajisjeve, të automjeteve, të makinerive, të ambienteve të punës dhe ndërtesës, të instalimeve elektrike, të ngrohjes, të ndërlidhjes radio-telefonike, të shërbimit swift-teleks, të shërbimit internet.
- Plotësimi i kërkesave për: projektide, detyra projektimi, projekte dhe preventiva ndërtimi, rikonstruksione apo ndërhyrje inxhinierike që realizohen nëpërmjet sektorit teknik ose kontraktuar me të tretë.
- Organizimi dhe ndjekja e shërbimit të postës për sistemin bankar, për shpërndarjen e botimeve, për shërbimin protokollar për dokumentacione e korrespondeca etj..

Përmirësimet strukturore, që janë bërë vazhdimisht, kanë patur për qëllim përshtatjen si dhe mbështetjen në përpjekjet e Bankës së Shqipërisë për modernizimin e teknologjisë bankare dhe të infrastrukturës etj..

Departamenti i Administrimit, me qëllimin rritjen e eficiencës dhe zhdërvjelltësisë për plotësimin e shërbimeve, për aktivitetet ndihmëse synon kalimin gradual të tyre në administrim me të tretë, nëpërmjet marrëveshjeve kontraktore.